



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 123, paragrafi (9) i Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90 /22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M

për udhëzimet e klasifikimit të incidenteve operative dhe të sigurisë dhe së metodës dhe procedurës të raportimit të incidenteve dhe mashtrimeve

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhen nga më afër:

- udhëzimet e klasifikimit të incidenteve të rëndësishme operative ose të sigurisë nga ofruesit e shërbimeve pagesore në pajtim me kriteret e përcaktuara, dhe
- metoda dhe procedura e raportimit të incidenteve dhe mashtrimeve të rëndësishme operative dhe të sigurisë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).

II. UDHËZIME PËR KLASIFIKIMIN TË INCIDENTIT OPERATIV TË RËNDËSISHËM OSE TË SIGURISË

2. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të klasifikojnë rëndësinë e incidentit operativ dhe të sigurisë duke vlerësuar ndikimin e tij nëpërmjet kriterëve të mëposhtme:

2.1 **"Transaksionet e prekura"** – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë vlerën totale të transaksioneve pagesore gjegjëse të prekura nga incidenti, si dhe përqindjen e tyre nga shuma e zakonshme e transaksioneve pagesore të ofruara përmes shërbimit pagesor gjegjës.

Transaksionet të prekura konsiderohen të gjitha transaksionet e brendshme dhe ndërkuftare që janë prekur drejtpërdrejt ose tërthorazi nga incidenti, ose kanë pasur potencial për t'u prekur.

Njëkohësisht, merren parasysh të gjitha transaksionet që nuk mund të fillohen ose përpunohen, ato me përmbajtje të ndryshuar në mesazhin e pagesës dhe ato të iniciuara me qëllim mashtrimi ose transaksionet realizimi i rregullt i të cilave është penguar ose kërcënuar në çfarëdo mënyre nga incident për më shumë se 1 (një) orë. Kohëzgjatja e incidentit matet nga momenti i ndodhjes së incidentit deri në momentin kur aktivitetet e rregullta rikthehen në të njëjtin nivel të cilësisë së shërbimit që kërcënohej nga incidenti.

Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që si shumë të zakonshme të transaksioneve pagesore, t'a llogarisin mesataren ditore vjetore të

transaksioneve pagesore vendase dhe ndërkufitare të kryera nëpërmjet shërbimeve pagesore të prekura nga incidenti, duke marrë si periudhë referimi për llogaritjen vitin e kaluar.

Pas përcaktimit të transaksioneve gjegjëse, përcaktohet vlera e tyre totale dhe përqindja e shumës së zakonshme të transaksioneve pagesore të ofruara përmes shërbimeve pagesore gjegjëse.

Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore vlerëson se shifra e marrë nuk është përfaqësuese, ai është i detyruar të përdorë përlogaritje tjetër përfaqësuese dhe të informojë Bankën Popullore për arsyet e përdorimit të metodës së zgjedhur të përlogaritjes.

2.2. "Përdoruesit e prekur të shërbimeve pagesore " – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë numrin e përdoruesve të shërbimeve pagesore të ndikuar nga incidenti dhe përqindjen e tyre ndaj numrit të përgjithshëm të përdoruesve të shërbimeve pagesore.

Si përdorues të prekur të shërbimeve pagesore konsiderohen të gjithë klientët që kanë marrëveshje me ofruesin e shërbimit pagesor që u ofron shërbimin pagesor të prekur dhe që kanë vuajtur ose do të vuajnë pasojat e incidentit që zgjat më shumë se 1 (një) orë. Kohëzgjatja e incidentit matet nga momenti i ndodhjes së incidentit deri në momentin kur aktivitetet e rregullta rikthehen në të njëjtin nivel të cilësisë së shërbimit që kërcënohej nga incidenti.

Ofruesit e shërbimeve pagesore, në pajtim me aktivitetet e mëparshme, janë të detyruar të vlerësojnë numrin e përdoruesve që ndoshta do të përdornin shërbimin pagesor gjatë incidentit.

Në rast se ofruesi i shërbimit pagesor është pjesë grupi, ofron ose përdor shërbime operative të subjekteve të tjera, ai është i detyruar të marrë parasysh vetëm përdoruesit e tij të shërbimeve pagesore.

Në përcaktimin e numrit total të përdoruesve, numri total i përdoruesve vendas dhe përdoruesve ndërkufitar të shërbimeve pagesore që kanë lidhur kontrata në momentin e ndodhjes së incidentit dhe që kanë qasje në shërbimin pagesor të prekur, pavarësisht nga madhësia dhe aktiviteti i tyre ose statusi pasiv.

2.3 "Siguria e dëmtuar e sistemeve të rrjeteve ose të sistemeve informative" – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë nëse ndonjë aktivitet keqdashës ka rrezikuar disponueshmërinë, vërtetësinë, integritetin ose besueshmërinë e rrjetit ose sistemeve informative (përfshirë të dhënat) në lidhje me ofrimin e shërbimeve pagesore.

2.4 "Ndërprerje e shërbimit"– Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë periudhën kohore gjatë së cilës fillimi dhe/ose ekzekutimi i shërbimit pagesor ose qasja në llogarinë pagesore nuk është në dispozicion të përdoruesit të shërbimit pagesor ose kohën gjatë së cilës urdhërpagesa nuk mund të realizohet.

Kohëzgjatja e ndërprerjes përcaktohet nga momenti i fillimit të ndërprerjes, duke marrë parasysh orarin e punës së ofruesve të shërbimeve pagesore në të cilat ofrohen shërbimet pagesore. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore nuk është në gjendje të përcaktojë momentin kur ka filluar ndërprerja e

shërbimeve, ai është i detyruar të llogarisë kohën e ndërprerjes nga momenti i zbulimit të ndërprerjes.

2.5 **“Ndikimi ekonomik”** – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë totalin e humbjeve financiare që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me incidentin, si dhe vlerën relative të tyre në raport me kapitalin e ofruesit të shërbimit pagesor.

Humbjet financiare përfshijnë paratë e humbura ose pronën, kostot e zëvendësimit të harduerit ose softuerit, kosto të tjera që lidhen me mjekësinë ligjore ose masat shtesë, tarifave për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, gjrobat, dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe të ardhurat e humbura. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të marrin parasysh vetëm ato humbje indirekte që tashmë dihen ose ka probabilitet të lartë që ato të ndodhin.

2.6 **“Niveli i forcuar i komunikimit të brendshëm”** – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë nëse incidenti është raportuar apo do t'u raportohet anëtarëve të organeve drejtuese.

Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë nëse, për shkak të ndikimit të incidentit në shërbimet pagesore, ekziston probabiliteti i shpalljes së situatës së krizës në pajtueshmëri me planin e vazhdimësisë së biznesit.

2.7 **“Mundësia që ofruesit e tjerë të shërbimeve pagesore dhe infrastruktura të jenë të ndikuar”** – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë pasojat e mundshme që incidenti do të shkaktonte për sistemin, respektivisht, potenciali i tij për t'u transferuar jashtë ofruesit të shërbimit pagesor të ndikuar.

Për këtë qëllim, bëhet vlerësim i ndikimit të incidentit në sistemin financiar, nëse ai është shtrirë edhe tek ofruesit e tjerë të shërbimeve pagesore, respektivisht nëse është e mundur të ndikohet në funksionimin e duhur të infrastrukturës së sistemit financiar.

2.8 **“Ndikimi në reputacion”** – Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përcaktojnë ndikimet negative të incidentit mbi besimin e përdoruesve në ofruesin e shërbimeve pagesore dhe humbjen e besimit në shërbimin pagesor dhe sistemin pagesor.

Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të marrin parasysh: nëse ka ankesa nga përdoruesit e shërbimeve pagesore dhe/ose ofruesit e tjerë të shërbimeve pagesore për ndikimin negativ të incidentit; nëse incidenti ka pasur ndikim të dukshëm në shërbimet pagesore dhe për këtë arsye mund ose do të mbulohet nga mediet (me kanale mediatike tradicionale dhe moderne - rrjetet sociale); nëse ka lëshime në përmbushjen e detyrimeve të kontratës sipas të cilave ekziston mundësia e pasojave juridike ndaj ofruesit të shërbimit pagesor; nëse ka lëshime në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe nëse kjo do të çonte në marrjen e masave rregullatore ndaj ofruesit të shërbimit pagesor dhe nëse një incident i ngjashëm ka ndodhur më parë.

3. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të vlerësojnë ndikimin e incidentit sipas secilit kriter klasifikimi dhe të përcaktojnë nëse pragjet e përcaktuara (të renditura në

tabelën nga paragrafi (1) i kësaj pike) janë arritur tashmë ose ka të ngjarë të arrihen, deri në zgjidhjen përfundimtare të incidentit.

Kriteri	Ndikim i ulët	Ndikim i lartë
transaksionet e prekura	(> 10% e nivelit të rregullt të transaksioneve të ofruesit të shërbimit pagesor (përsa i përket numrit të transaksioneve) dhe kohëzgjatja e incidentit > 1 orë *) ose (> 31 000 000 denarë dhe kohëzgjatja e incidentit > 1 orë *)	(> 25% e nivelit të rregullt të transaksioneve të ofruesit të shërbimit pagesor (përsa i përket numrit të transaksioneve) ose (> 310 000 000 denarë)
Përdoruesit e ndikuar të shërbimeve pagesore	(> 5.000 dhe kohëzgjatja e incidentit > 1 orë *) ose (> 10% nga përdoruesit e shërbimeve pagesore të ofruesit të shërbimit pagesor dhe kohëzgjatja e incidentit > 1 orë *)	(> 50 000) ose (> 25% nga përdoruesit e shërbimeve pagesore të ofruesit të shërbimit pagesor)
Ndërprerja e shërbimit	> 2 orë	Nuk zbatohet
Dëmtim i sigurimit të rrjetit ose e sistemeve të informacionit	Po	Nuk zbatohet
Ndikimi ekonomik	Nuk zbatohet	Dëmtimi i drejtpërdrejtë: > Maksimumi prej: (0,1% nga kapitali themelor; 12.400.000 denarë) ose Dëmtim i tërthortë: > 310.000.000 denarë
Nivel i rritur i komunikimit të brendshëm	Po	Po, dhe aktivizimi i situatës së krizës në pajtim me planin e vazhdimësisë së biznesit

Mundësia që ofruesit dhe infrastrukturat e tjera të shërbimeve pagesore të preken	Po	Nuk zbatohet
Ndikimi në reputacion	Po	Nuk zbatohet

* Pragu i kohëzgjatjes së incidentit më të gjatë se 1 (një) orë i referohet incidenteve operative që kanë ndikim në fillimin dhe/ose përpunimin e transaksioneve pagesore.

4. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të klasifikojnë incidentin operativ ose e sigurisë si të rëndësishëm, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - të paktën një kriter klasifikimi ka nivel të lartë ndikimi, në pajtim me tabelën nga pika 3), paragrafi (1) i këtij vendimi ose
 - të paktën tre kritere klasifikimi kanë nivel të ulët ndikimi, në pajtim me tabelën nga pika 3), paragrafi (1) i këtij vendimi.

5. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore nuk kanë të dhëna të sakta për të mbështetur vlerësimet e tyre nëse një kriter i caktuar është arritur ose ka të ngjarë të arrihet përpara zgjidhjes së incidentit, ata duhet të kryejnë vlerësim.

Vlerësimi nga paragrafi (1) i kësaj pike të Vendimit mund të përdoret në fazën fillestare të incidentit.

6. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar gjatë kohëzgjatjes së incidentit të bëjnë vazhdimisht vlerësime për ndryshimet në lidhje me klasifikimin e incidentit, veçanërisht drejt nivelit më të lartë (incidenti që nuk është i rëndësishëm bëhet i rëndësishëm) ose drejt nivelit më të ulët (incident i rëndësishëm të riklasifikohet si i pa rëndësishëm).

Për çdo riklasifikim të një incidenti nga një nivel i rëndësishëm në një incident që nuk është i rëndësishëm, Banka Popullore duhet të njoftohet menjëherë.

III. PROCEDURA E NJOFTIMIT TË NJË INCIDENTI TË RËNDËSISHËM OPERATIV DHE TË SIGURISË NË BANKËN POPULLORE

7. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që të përgatisin dhe t'i dorëzojnë Bankës Popullore raport për incidentin e rëndësishëm operativ dhe të sigurisë, i cili është parapara në shtojcën 1 të këtij vendimi.

Për çdo incident, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të paraqesin raportin fillestar, të ndërmjetëm dhe përfundimtar duke përdorur formularin e përkthyer A, B ose C në shtojcën 1 të këtij vendimi.

Ofruesit e shërbimeve pagesore konsiderohen se i kanë dorëzuar siç duhet të dhënat nëse:

- zbatohen në Bankën Popullore në afatet e parapara me vendimin;
- janë të sakta dhe të plota.

8. Në rast se incidenti ka ose mund të ketë ndikim në situatën ekonomike të përdoruesve të shërbimeve pagesore, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar t'i dorëzojnë Bankës Popullore kopje të informacionit të ofruar për përdoruesit e shërbimeve pagesore për incidentin që ka ndodhur dhe për masat që duhet të marrin për të reduktuar efektet negative.

9. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që me kërkesë të Bankës Popullore të dorëzojnë dokumente shtesë si mbështetje për informacionin e dorëzuar me formularin e përcaktuar.
10. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit të shkëmbyer.

Raporti fillestar

11. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që menjëherë dhe pa vonesa të panevojshme ta dorëzojnë raportin fillestar me plotësimin e formularit A në Bankën Popullore dhe jo më vonë se tre ditë pasi incidenti të klasifikohet si i rëndësishëm.
12. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të klasifikojnë rëndësinë e incidentit, në pajtim me pikën 4) të këtij vendimi, jo më vonë se 24 orë pas zbulimit të incidentit.
Nëse për klasifikimin e incidentit nevojitet periudhë më e gjatë kohore, ofruesi i shërbimit pagesor duhet të deklarojë në raportin fillestar arsyet pse klasifikimi nuk mund të kryhet.
Ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar të paraqesë raport fillestar edhe në rastin kur incidenti që më parë është klasifikuar si i rëndësishëm riklasifikohet si incident i rëndësishëm, menjëherë pas ndryshimit të statusit.

Raporti kalimtar

13. Pas normalizimit të aktiviteteve të rregullta, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që të dorëzojnë raportin kalimtar në Bankën Popullore.
Normalizimi i aktiviteteve të rregullta të ofruesve të shërbimeve pagesore do të konsiderohet atëherë kur aktivitetet e rregullta do të zhvillohen me të njëjtin nivel shërbimi siç përcaktohet ose është vendosur nga ofruesi i shërbimit pagesor dhe kur nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.
Nëse aktivitetet e rregullta nuk normalizohen, ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar të dorëzojë raport kalimtar brenda tri ditëve pune nga dorëzimi i raportit fillestar.
14. Raporti kalimtar duhet të përmbajë përshkrim të detajuar të incidentit dhe pasojave të tij duke plotësuar formularin B. Në rast të mungesës së të dhënave të sakta, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të zbatojnë një procedurë vlerësimi kur plotësojnë fushat e kërkuara në formularë.
15. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të përditësojnë informacionin e specifikuar në seksionet e formularit A dhe formularit B, në rast të ndryshimeve të rëndësishme që kanë ndodhur që nga dorëzimi i raportit të mëparshëm kalimtar.
16. Nëse në periudhën prej tre ditësh nga momenti kur incidenti është klasifikuar si i rëndësishëm, vendoset operimi i rregullt, ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar që njëkohësisht të dorëzojë raport fillestar dhe të ndërmjetëm (formularët A dhe B) deri te Banka Popullore në afatin e caktuar prej tre ditësh nga pika 11) e këtij vendimi.

Raporti përfundimtar

17. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të paraqesin raport përfundimtar pas kryerjes së analizave të hollësishme për të zbuluar shkaqet e incidentit duke plotësuar formularin C.

18. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar që raportin përfundimtar t'a dorëzojnë në Bankën Popullore jo më vonë se 20 ditë pune nga data e normalizimit të punëve të rregullta.

Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore nuk janë në gjendje të zbulojnë arsyet e vërteta të ndodhjes së incidentit ose akoma nuk kanë të dhëna të sakta për përditësimin e raporteve të mëparshme, ata janë të detyruar të kërkojnë nga Banka Popullore zgjatjen e afatit për dorëzimin e raportin përfundimtar nga paragrafi (1) i kësaj pike.

Në kërkesën nga paragrafi (2) i kësaj pike të vendimit, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të deklarojnë arsyet e shtyrjes së afatit, si dhe të kryejnë vlerësim të datës së dorëzimit të raportit përfundimtar.

19. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar në raportin e tyre përfundimtar t'a informojnë Bankën Popullore për:

- të dhënat e sakta në formularët A dhe B, në vend të vlerave të vlerësuara dhe
- shkaku i përcaktuar i incidentit, nëse dihet dhe masat e marra ose të planifikuara për të parandaluar përsëritjen e tij.

20. Në rastin e konstatimit të rastit kur incidenti i raportuar nuk plotëson kriteret për klasifikimin e tij si të rëndësishëm, ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar të paraqesë menjëherë raportin përfundimtar, përpara afatit të parashikuar nga pika 18), pika (1) e këtij vendimi.

Në rastet e përmendura në paragrafin (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar në vend të plotësimit të formularit C të shënojnë kutinë **"incidenti u riklasifikua si i parëndësishëm"** dhe të shpjegojnë arsyet që justifikojnë riklasifikimin.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

21. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e këtij vendimi jo më vonë se 19 shkurti 2024.

Ofruesit e shërbimeve pagesore që janë krijuar deri në datën e zbatimit të këtij vendimi dhe që kanë licencë për të krijuar dhe operuar me bankë zbatojnë dispozitën e pikës 47) nga Vendimi për Metodologjinë e Sigurisë së Sistemit Informativ të Bankës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/18) deri në ditën e pajtueshmërisë të veprimtarisë së saj me kërkesat e këtij vendimi dhe jo më vonë se 19 shkurti 2024.

22. Pika 47) e Vendimit për Metodologjinë e Sigurisë së Sistemit Informativ të Bankës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/18.) pushon së vlejture më 20 shkurt 2024.

23. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V nr. 02-15/XXII-9/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

Shtojca 1:

Formulari A (Raporti fillestar)

Извештај за значаен инцидент			
Почетен извештај		Со вклучувањето три дена со класификација на инцидентот за значаен	
Датум на вклучување од инцидентот		Датум на извештај	
Учестван вид на инцидентот			
ОБРАЗЕЦ (А - Почетен Извештај)			
A.1 - ОБЩИ ПОДАТОЦИ			
Примарен контакт		Email	Тип
Вторичен контакт		Email	Тип
A.2 - ОТКРИВАЊЕ И КЛАСИФИКАЦИЈА			
Датум и време на откривање на инцидентот од примарен контакт			
Датум и време на класификација на инцидентот од примарен контакт			
Инцидентот беше откриен од:			
Тип на инцидент			
Критериум за значаеност:			
☐ Значаен трансакционен	☐ Значаен трансакционен на поддршка (support)	☐ Промени на резултат	☐ Невредна сигурност на информациите од значаен
☐ Значаен трансакционен на поддршка (support)	☐ Значаен трансакционен на поддршка (support)	☐ Значаен трансакционен на поддршка (support)	☐ Значаен трансакционен на поддршка (support)
Брзина и вкупно однесување на инцидентот			
Дали известувате други надлежни органи			
Причини за касно пријавување на почетен извештај			

Formulari B (Raporti kalimtar)

Извештај за значаен инцидент			
Природен инцидент	или сепак 3 работни дена од поднесувањето на почетен извештај или притоа ден природен инцидент		
Датум на поднесување (ДД/ММ/ГГГГ) _____	Уникатен код на инцидентот _____	Време (часови) _____	_____
ОБРАЗЕЦ Б - Природен Извештај			
Б.1 - ОПШТИ ПОДАТОЦИ			
Пополни детали за инцидентот: Што се случило со случајот? _____ Како започнал инцидентот? _____ Како се развил? _____ Кој се последниот ден (за корисниците на платените услуги)? _____			
Датум за инцидентот со известие/корисниците на ПУ?	_____	Ако е „Да“, камадејте: _____	_____
Датум и време со притоа ден инцидентот?	_____	Ако е „Да“, камадејте: _____	_____
Датум и време кога и/или случајот надлежен/надлежувачи се опфатени?	_____	Ако е „Да“, камадејте: _____	_____
Датум управување со криза и започнато (внатрешно надлежност)?	_____	Ако е „Да“, камадејте: _____	_____
Датум и време на започнување на инцидентот (државна и надлежност/услуга) (ДД/ММ/ГГГГ часи) _____			
Датум и време кога и/или случајот надлежен/надлежувачи на инцидентот (ДД/ММ/ГГГГ часи) _____			
Заклучоци/функционален поддршка:	☐ Материјална/информација ☐ Други корисници ☐ Консултации ☐ Информационна инфраструктура ☐ Други ☐ Други		
Примено направило во притоа ден инцидентот _____			
Б.2 - Класификација на инцидент (информација за инцидент)			
Заклучоци/транзакции (1)	Времетраење: _____ Број на заклучоци/транзакции _____ Како бидејќи бројот на заклучоци/транзакции во (MIS/DUR) _____ Транзит на инцидентот (со правен или само за опфатени инцидентот) _____ Комадејте: _____		
Заклучоци/корисници на платените услуги (2)	Времетраење: _____ Број на заклучоци/корисници _____ Како бидејќи бројот на заклучоци на ПУ _____		
Нарушавачка ситуација на инфраструктурата или информациите системи	☐ Општи или инфраструктурата системи се опфатени _____		
Привремена услуга	Времетраење на привремена: _____ Денови: _____ Часови: _____ Минути: _____ Времетраење _____ Директна услуга во MIS/DUR _____ Информациона услуга во MIS/DUR _____		
Заклучоци/најлош на интернет комуникација	Општеството на интернет комуникација на инцидентот, директно или посредно да биде започнато управување со криза или _____ Комадејте: _____		
Можеби да бидат заклучоци/други заклучоци на платените услуги и инфраструктура	Општеството инцидентот може да заклучи други заклучоци на платените услуги или инфраструктура _____ Комадејте: _____		
Општеството на регулација	Општеството или регулација на инцидентот на ПУ (нпр. медиумско поврзување, објави или правни постапки и сл.) _____ Комадејте: _____		
Б.3 - ОПИС НА ИНЦИДЕНТОТ			
Тип на инцидент	☐ Општеството ☐ Консултации на интернет ☐ Притоа ден инцидентот ☐ Притоа ден инцидентот ☐ Информациона услуга ☐ Други		
Примено за привремена на инцидентот	_____ _____ _____ _____ _____ _____		
Датум инцидентот и директно или инцидентот, праву друг заклучоци на инцидентот?	_____ _____ _____		
Б.4 - ФАКТ НА ИНЦИДЕНТОТ			
Својствен ефект	☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Консултации ☐ Други заклучоци ☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци		
Заклучоци/други заклучоци	☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Консултации ☐ Други заклучоци ☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци		
Заклучоци/платените услуги	☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Консултации ☐ Други заклучоци ☐ Информациона услуга ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци ☐ Други заклучоци		
Б.5 - УПОРАЗУВАЊА НА ФАКТИТЕ НА ИНЦИДЕНТОТ			
Како инцидентот/други се привремена до сета за надлежност на инцидентот?	☐ _____ _____ _____		
Датум поднесување за инцидентот и инцидентот?	☐ _____ _____ _____		

Известията за значаен инцидент		
Изберете го типът на инцидента:	на ден на 24 работни дни от излизането на приложимият специален закон	
По молба (обикновено чрез е-поща) за разследване на инцидента (не поканете само за известията разследващи само инцидента)		
Датум на известието (ДД/ММ/ГГГГ)	Време (часове)	
Уведомен код на инцидента		

10